



“Faktoje” është themeluar në maj të vitit 2018 me mbështetjen e plotë teknike nga projekti “Drejtësi për të gjithë” i financuar nga USAID-i dhe i zbatuar nga EWMI.

Faktoje është një qendër mediatike që merret me verifikimin e fakteve duke vlerësuar deklaratat e zyrtarëve publikë dhe politikanëve, si dhe duke analizuar çështje me interes dhe ndikim madhor publik që përfshijnë tematikat kyçe në jetën e shoqërisë. Më shumë se 300 deklarata dhe premtime në vit vlerësohen sipas kriterëve të vërtetësisë, konsistencës dhe përmbushjes së premtimeve.

Faktoje” është e vetmja media fakt-verifikuese në Shqipëri që nxit dhe promovon llogaridhënien bazuar në të drejtën e informimit dhe transparencën.

Në punën tonë të përditshme, ne përpiqemi të fuqizojmë qytetarët e Shqipërisë dhe të rrisim transparencën për premtimet dhe pretendimet e bëra nga zyrtarët publikë apo subjektet private që përfitojnë nga fondet publike. Ky proces synon informimin e shëndetshëm, edukimin mediatik dhe nxitjen e vendimmarrjes së përgjegjshme qytetare.

“Faktoje”, si anëtare nënshkruese e IFCN-së (Rrjeti Ndërkombëtar i Verifikuesve të Fakteve) dhe bashkëthemeluese e Rrjetit të Anti-Dizinformimit për Ballkanin (ADN), verifikon artikujt sa u përket fakteve duke u bazuar në burime të besueshme që mund të gjenden edhe jashtë Shqipërisë.

Si pjesë e IFCN-së, ne ndjekim të njëjtat rregulla dhe metodologji që na ndihmojnë të forcojmë bashkëpunimin dhe të ruajmë pavarësinë dhe profesionalizmin.

“Faktoje” ishte pjesë e grupit të punës me të drejtë vote, mes 40 organizatave të tjera të verifikimit të fakteve në Evropë, të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e Kodit të Parimeve Profesionale të Rrjetit Evropian të Verifikimit të Fakteve (EFCSN).

Qëllimi përfundimtar i “Faktoje” është përmirësimi i standardeve të performancës publike në Shqipëri.

Gjatë këtyre viteve, kjo platformë është kthyer në një burim të besueshëm informacioni për publikun e gjerë, duke dhënë shembullin e një gazetarie të përgjegjshme dhe etike.

Aktivitetet

Verifikimi i fakteve të deklaratave politike

Çdo vit, "Faktoje" verifikon të paktën 300 deklarata dhe premtime publike dhe punon për verifikime të thelluara të mënyrave se si shpenzohen paratë e taksapaguesve shqiptarë.

"Faktoje", si pjesë e një rrjeti të fortë për Ballkanin Perëndimor, punon për të ekspozuar ndikimin dashakeq dhe të dëmshëm të përhapur nga aktorët e huaj në Shqipëri. Çdo vit, kontrollojmë dhe verifikojmë faktet e më shumë se 60 artikujve dhe çdo vit publikojmë një raport mbi dezinformimin dashakeq në Ballkanin Perëndimor.

Monitorimi i llogaridhënies së pushtetit vendor

Nga viti 2019 e në vazhdim, "Faktoje" publikon "Raportin e monitorimit të transparencës në bashki dhe vlerësimit të premtimeve të kryetarëve të bashkive".

Gjetjet e raporteve dhe rekomandimet janë ndarë me kryetarët e bashkive dhe me anëtarët e shoqërisë civile çdo vit.

Që nga viti 2019 "Faktoje" ka verifikuar premtimet, deklaratat dhe përmbushjen e afateve të vendosura për procesin e rimëkëmbjes pas tërmetit shkatërrues të nëntorit 2019 dhe transparencën e menaxhimit të parasë publike.

"Faktoje" ka ndërtuar një bazë të centralizuar të dhënash për grantet, bonuset e qirave dhe një listë të individëve që përfitojnë banesa të reja sipas një sistemi pikëzimi dhe të karakteristikave të tyre familjare.

Në vitin 2021, "Faktoje" ka publikuar një raport me gjetje dhe rekomandime lidhur me premtimet dhe transparencën e fondeve të dedikuara për rindërtimin e banesave publike të prekura nga tërmeti i vitit 2019.

Trajnim dhe mentorim

"Faktoje", që nga viti 2019 – vazhdon bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës për t'iu ofruar studentëve mundësinë e praktikës profesionale pranë "Faktoje".

"Faktoje" ka krijuar një kurs 14 javor për Verifikimin e Fakteve, për nivelin Bachelor në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës (2021-2023).

Nga viti 2020, "Faktoje" trajnon gazetarë dhe studentë vendas nga 6 qarqe të Shqipërisë me fokus dezinformimin, keqinformimin, metodologjinë e verifikimit të fakteve dhe edukimin mediatik.

"Faktoje" organizon dhe drejton trajnime me koordinatorët në të gjitha institucionet publike dhe gazetarët për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

"Faktoje" po trajnon qindra nxënës të shkollave të mesme në të gjithë Shqipërinë për metoda të thjeshta të verifikimit të fakteve dhe për thellimin e të menduarit kritik.

Fushatë dezinformuese: Mos u RREJ! Fako dhe ti!

Nga viti 2019 e në vazhdim, "Faktoje" ka zhvilluar disa fushata sensibilizuese për të ndaluar dezinformimin në rrjetet sociale, në lidhje me pandeminë Covid-19, tërmetin, luftën në Ukrainë, mjedisin etj.

Çështje në Gjykatë

Nga viti 2019, "Faktoje" ka çuar në gjykatë 13 institucione publike që refuzuan të bëjnë publike shpenzimet e zyrtarëve të tyre për udhëtime pune jashtë vendit.

Në pjesën dërrmuese të padive, Gjykata Administrative vendosi në favor të "Faktoje"; megjithatë, shumë institucione refuzojnë t'i bëjnë publike shpenzimet e tyre. Pavarësisht vendimit të Gjykatës që i detyron të dorëzojnë faturat, dy institucione, konkretisht Presidenca dhe Ministria e Punëve të Jashtme, refuzuan t'i vinin këto fatura në dispozicion edhe pas ndërhyrjes së Përmbartimit, institucionit të ngarkuar me zbatimin e vendimeve të gjykatës.

Çështja është ende në proces në Gjykatën e Apelit për institucione të tjera të rëndësishme, si Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë.

Për herë të parë një media ka ngritur të njëjtën padi ndaj 13 institucioneve, një betejë ligjore që vijon të me përfaqësimin ligjor nga Republika.

Partnerët

Transparenca është thelbësore kur vjen fjala tek burimet e financimit. Të gjitha të dhënat financiare, ligjore dhe organizative të Faktoje janë të publikuara në faqen tonë të internetit. Partnerët e "Faktoje" janë USAID, National Endowment for Democracy (NED), Ambasada Britanike, Departamenti Amerikan i Shtetit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ambasada e Mbretërisë së Holandës, Ambasada e Suedisë, OSBE, UNESCO, GIZ, META, etj.